



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER STELA R. DEMNERI  
ADRESA NR.5, GJIK KUQALI,  
PALL "FERAR", NR.1, NR.13  
TEL: 692437001



## AKT MARRËVESHJE

(KONTRATE KALIMI E TE DREJTAVE REALE)

Nr. repertori: 1858

Nr. koleksioni: 696

Tirane më 28/06/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2021051380077878564



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

Nr. 1858 Rep.

Nr. 696 Kol.



A2021051380077878564

KONTRATE TRANSFERIMI TE DREJASH DHE DETYRIMESH

(Nepermjet dhurimit)

Sot, më datë 28 / 06 / 2021, para meje Notere Stela R. Demneri, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tiranë, Nr.5, Rr. "Gjik Kuqali", Pall "Ferar", Nr.1, Nr.13, u paraqitën personalisht:

- **Z. Alban Efthimi**, atesia Romeo, amesia Tamara, shtetas Shqiptar, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, me adrese Grigor Heba; Nd. 1831; H. 1; Ap. 001; Njesia Administrative Nr. 5, Tirane, lindur me 13/10/1970, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036022174 dhe nr. personal H01013093A, zotërues i 80% të kuotave të Shoqërisë "Texas Development" sh.p.k, NUIS L91317004K (këtu e mëposhtë i referohemi si pala e parë)
- **Shoqëria "Zurich Investment Group" sh.p.k**, regjistruar si person juridik në QKB me NUIS M11825004M, me adresë Rruga E Kosovareve, Pallati Dolçka' , Apartamenti 1/2 , Njesia Administrative Nr. 5, Tirane, përfaqësuar nga Administratori **Z. Alban Efthimi**, atesia Romeo, amesia Tamara, shtetas Shqiptar, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, me adrese Grigor Heba; Nd. 1831; H. 1; Ap. 001; Njesia Administrative Nr. 5, Tirane, lindur me 13/10/1970, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036022174 dhe nr. personal H01013093A, (këtu e mëposhtë i referohemi si pala e dytë)

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, unë noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, pasi kanë marrë konsulencën e duhur ligjore dhe konsultuar me specialist ligjor të fushës, si dhe duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 110 / 2018 'Për Noterinë'; Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare', i ndryshuar, bien dakord dhe kërkojnë hartimin e kesaj kontrate si vijon.

**Neni 1: Objekti i kontratës**

1. Z. Alban Efthimi është ortak në shoqërinë "Texas Development" sh.p.k, me pjesëmarrje 80% të kapitalit të përgjithshëm. Gjithashtu, Z. Alban Efthimi është ortak i vetem, zotërues 100 % i të gjithë kapitalit të shoqërisë "Zurich Investment Group" sh.p.k.
2. Bazuar ne vendimet e asambleve, respektivisht, vendimi i Asamblese se "Texas Development" sh.p.k dhe vendimi i Asamblesë së "Zurich Investment Group" sh.p.k, Z. Alban Efthimi kërkon t'i transferojë shoqërisë "Zurich Investment Group" sh.p.k 100 % të kuotave të tij, që përbëjnë 80% të kuotavë totale të Shoqërisë "Texas Development" sh.p.k.



A2021051380077878564

## Neni 2: Transferimi

1. Palët në këtë marrëveshje bien dakord të kryejnë transferimin e kuotave nga Z. Alban Efthimi si ortak i shoqërisë "Texas Development" sh.p.k, te shoqëria "Zurich Investment Group" sh.p.k, me ortak të vetëm Z. Alban Efthimi.
2. Kuotat do të kalojnë nga Z. Alban Efthimi, si ortak i shoqërisë "Texas Development" sh.p.k, te Z. Alban Efthimi, si ortaku i vetëm i shoqërisë "Zurich Investment Group" sh.p.k. Pra, meqenëse si individ, është i njëjti person fizik, (Z. Alban Efthimi), por në statuset e ndryshme juridike-tregtare, pra si ortak i "Texas Development" sh.p.k, Z. Alban Efthimi heq dorë nga pronësia, cdo e drejtë dhe detyrim që rrjedh nga këto kuota, si dhe ia transferon, bashkë me pronësinë e tyre, shoqërisë "Zurich Investment Group" sh.p.k.

## Neni 3: Kundërshpërblimi

1. Për arsyet e parashtruara në nënin e mësipërm, transferimi do të kryhet pa kundërshpërblim meqenëse në rastin konkret, praktikisht po Z. Alban Efthimi do t'i mbajë këto kuota, por do t'i ndryshojë cilësinë, nga ortak i shoqërisë së "Texas Development" sh.p.k, do t'i kalojë e drejta e pronësisë mbi kuotat objekt i kësaj kontrate, si ortaku i vetëm i shoqërisë "Zurich Investment Group" sh.p.k.

## Neni 4: Te drejtat dhe detyrimet

1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Z. Alban Efthimi do t'i transferojë tërësisht pronësinë e kuotave që ai ka në shoqërinë "Texas Development" sh.p.k (80% të kuotave totale të shoqërisë), shoqërisë "Zurich Investment Group" sh.p.k.
2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Z. Alban Efthimi del nga ortakëria e "Texas Development" sh.p.k, pa pasur dhe/ose mbartur asnjë të drejtë dhe detyrim.
3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, "Zurich Investment Group" sh.p.k, bëhet ortakë me 80% të kuotave totale të shoqërisë "Texas Development" sh.p.k, dhe si e tillë, kjo shoqëri merr përsipër të mbartë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që vijnë nga ky transferim.
4. Shoqëria "Zurich Investment Group" sh.p.k, merr përsipër të paguajë të gjitha detyrimet e mëparshme të pashlyra nga Z. Alban Efthimi, në rast se ka të tilla.
5. Shoqëria "Zurich Investment Group" sh.p.k merr përsipër të gjitha të drejtat, si dhe do të paguajë të gjitha detyrimet e mëpasshme që vijnë nga cilësia e tij si ortak me 80% të kuotave totale të shoqërisë "Texas Development" sh.p.k.
6. Në momenti që do të vendoset shpërndarja e fitimeve (dividenteve) nga shoqëria "Texas Development" sh.p.k, cdo detyrim tatimor do të paguhet nga shoqëria "Zurich Investment Group" sh.p.k, në momentin që kjo shoqëri do të vendosë të shpërndajë fitimet (dividentët) e saj.

## Neni 5: Dispozita të fundit

1. Të dyja palët e nënshkruese, bien dakord me dispozitat e kësaj kontrate, e cila hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e saj nga të dyja këto palë.



A2021051380077878564

2. Me nënshkrimin dhe regjistrimin e kesaj marreveshje ne Qendrën Kombëtare të Biznesit, ortakëria e "Texas Development" sh.p.k do të rezultojë:

- Shoqëria "Zurich Investment Group" sh.p.k - ortak me 80 % te kuotës
  - Z. Olsi Efthimi - ortak me 10 % te kuotës
  - Z. Andi Efthimi - ortak me 10 % te kuotës
- Çdo mosmarrëveshje që do të lindë mes palëve, në lidhje me këtë kontratë do të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve. Vetëm në rast se sërish palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjet, atëherë do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranës

Kjo Kontrate u lexua nga une Noterja me ze te larte dhe ne menyre te qarte ne prani te paleve, te cilet me deklaruan se e kuptuan permbajtjen e saj dhe meqenese ajo shpreh vullnetin e tyre te lire e te plote, u njohen dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nenshkruajne ate rregullisht perpara meje Noteres. Une Noterja, verifikova identitetin e paleve nepermjet dokumenteve te identitetit dhe pasi e gjeta permbajtjen e aktit noterial te mesiperm, ne perputhje te plote me nenin 62, 63 te ligjit nr. 110/2018 "Per Noterine", vertetoj nenshkrimin e tyre. Ne zbatim te ligjit nr. 9887, date 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave Personale", une Noterja deklaroi se do te ruaj dhe perpunoj te dhenat personale te subjekteve te kesaj marreveshjeje, ne menyre te drejte dhe te ligjshme.

Palët nënshkruese:

Z. Alban Efthimi

Shoqëria "Zurich Investment Group" sh.p.k  
Admin. Z. Alban Efthimi



NOTERE  
STELA R. DEMNERI



Nr. 7

**Vendim i Asamblesë së Përgjithshme  
“Texas Development” Sh.p.k**

Sot, më datë **28/06/2021**, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë “**Texas Development**” Sh.p.k, me adresë në: **Rruga e “Kosovarëve”, Pall. Dolcka, Ap 1/2, “Njësia Administrative Nr.5, 1019 Tiranë, ”**, mbajti mbledhjen e përbërë nga:

- Z. Alban Efthimi**, i biri i Romeo-s, lindur më datë 13.10.1970 në Tiranë, i identifikuar me nr. personal H01013093A, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, zotërues i 80% të kuotave të Shoqërisë.
- Z. Andi Efthimi**, i biri i Romeo-s, lindur më datë 04.01.1978 në Tiranë, i identifikuar me nr. personal H80104093K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, zotërues i 10% të kuotave të Shoqërisë.
- Z. Olsi Efthimi**, i biri i Romeo-s, lindur më datë 04.01.1978 në Tiranë, i identifikuar me nr. personal H80104094S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, zotërues i 10% të kuotave të Shoqërisë.

**ME REND DITE:**

1. Te miratohet kalimi dhe transferimi i **100 %** (njëqind për qind) te kuotave te ortakut Alban EFTHIMI te cilat korrespondojnë me **80%** (tetëdhjetë për qind) të kapitalit total të shoqërisë, nga ortakut Z. Alban EFTHIMI në emër të personit juridik “**Zurich Investment Group**” shpk.

Pas diskutimit të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme,

**VENDOSI:**

Të pranojë kalimin e 100% (njëqind për qind) të kuotave të ortakut Z. Alban EFTHIMI, që korrespondojnë me 80% të kapitalit total të shoqërisë, nga ortakut Z. Alban Efthimi në emër të personit juridik “**Zurich Investment Group**” shpk.

Me përmbushjen e detyrimit të palëve- pra me nënshkrimin e kontratës për kalimin e kuotave dhe regjistrimin e saj në institucionet përkatëse, administrimi dhe ortakëria e shoqërisë do të rezultojë:

- I. **Z. Alban EFTHIMI – administrator i vetëm, jo ortak**
- II. **“Zurich Investment Group” shpk. – ortak me 80 % tetëdhjetë për qind( të kuotave me vlerë ALL 80,00 (tetëdhjetë Lekë)**
- III. **Z. Olsi EFTHIMI – ortak me 10% (dhjetë për qind) të kuotave me vlerë ALL 10,00 (dhjetë Lekë);**
- IV. **Z. Andi EFTHIMI – ortak me 10 % (dhjetë për qind) të kuotave me vlerë ALL 10,00 (dhjetë Lekë).**





Texas  
Development



Texas Development Sh.p.k  
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Z. Alban Efthimi

*Alban Efthimi*  
*[Signature]*



Texas  
Development

Z. Olsi Efthimi

OLSI EFTHIMI  
*[Signature]*

Z. Andi Efthimi

*Andi Efthimi*  
*[Signature]*



Texas Development Rruga e Kosovareve, Pall. Dolça, Ap 1/2, Tirane 1019 Tirane, Shqipëri

Nr. 1

**Vendim i Asamblesë së Përgjithshme  
“Zurich Investment Group” Sh.p.k**

Sot, më datë **28/06/2021**, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë “Zurich Investment Group” Sh.p.k, me adresë në: **Rruga e “Kosovarëve”, Pall. Dolcka, Ap 1/2, “Njësia Administrative Nr.5, 1019 Tiranë, ”**, mbajti mbledhjen e përbërë nga

**-Z. Alban Efthimi**, i biri i Romeo-s, lindur më datë 13.10.1970 në Tiranë, i identifikuar me nr. personal H01013093A, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, ortak i vetem, zotërues i **100%** të kuotave të shoqërisë.

**ME REND DITE:**

1. Te miratohet kalimi dhe transferimi i **100 %** (njëqind për qind) te kuotave të ortakut të Shoqërisë Texas Development shpk, Z. Alban EFTHIMI te cilat korrespondojnë me **80%** (tetëdhjetë për qind) të kapitalit total kësaj shoqërie, në emër të shoqërisë “Zurich Investment Group” shpk.

Pas diskutimit të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme,

**VENDOSI:**

Të pranojë kalimin e 100% (njëqind për qind) të kuotave të ortakut të shoqërisë Texas development shpk, Z. Alban EFTHIMI, që korrespondojnë me 80% të kapitalit total të kësaj shoqërie, te shoqëria “Zurich Investment Group” shpk.

Me përmbushjen e detyrimit të palëve, pra me nënshkrimin e kontratës për kalimin e kuotave dhe regjistrimin e saj në institucionet përkatëse:

- I **Miratohet** kalimi dhe transferimi i **100 %** (njëqind për qind) te kuotave të ortakut të Shoqërisë Texas Development shpk, Z. Alban EFTHIMI te cilat korrespondojnë me **80%** (tetëdhjetë për qind) të kapitalit total kësaj shoqërie, në emër të shoqërisë “Zurich Investment Group” shpk
- II **Shoqëria Zurich Investment Group bëhet ortak e Shoqërisë Texas Development duke zotëruar 80% të kuotave të kësaj shoqërie.**

**Zurich Investment Group Sh.p.k  
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

**Zurich Investment Group  
Sh.p.k.  
NUIS : M11825004M  
TIRANË - ALBANIA  
Z. Alban Efthimi**

*Alban Efthimi*  
*[Signature]*